



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues LABU I-E-N, Nr.Prot. 278, Data 22.06.2022,

Shkurtimi i lëndës Documentacioni i mbledhjes së "KBU Ishëm"

Për trajtim nga:	<u>Dr. Konrad P. Zizi / Dr. Bonenti</u>
(struktura te tjera të ngarkuara	<u>Të reflektohen edhe ndryshimet në sistemin</u>
Me porosi	

Afati:  Normal (7 ditë)  Prioritet (3 ditë)  Urgjent (brenda ditës)  Pa afat/për dijani  
Tjetër ditë

Data 30.06.2022 Nr. Prot. 1205

Nënshkrimi:(Titullari)

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_,

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim (stuktura): \_\_\_\_\_,

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_,

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim (stuktura): \_\_\_\_\_,

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_,

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim Specialisti : \_\_\_\_\_,

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit përfunduar më: \_\_\_\_\_, Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit pranuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE  
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN-MAT

AGJENCIA E MENAXHIMIT  
TË BURIMEVE UJORE  
Nr. 1205 Prot.  
Datë, më 30.06.2022

Nr. 278 Prot.

Tiranë, më 27.062022

**Lënda :** Dokumentacioni i mbledhjes së KBU Ishëm datë 11.05.2022

**AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", prona nr. 33, ish shtëpia e ushtarakëve, Tiranë

Në mbështetje të vendimit Nr.6 datë 12.06.2019 "Për miratimin e rregullores Këshillit të Basenit Ujor" neni 23 po j'u përcjellim dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit të Basenit Ujor Ishëm te datës 11.05..2022 si më poshtë;

1. Vendimin nr. 3 datë 11.05.2022 - një kopje.
2. Raportin përmbledhës të mbledhjes datë 11.05.2022

**DREJTOR**

**Helio Huqi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr. 3, datë 11.05.2022

PËR

“PËR KONSTITUIMIN E KËSHILLIT TË BASENIT UJOR ISHËM”


Bazuar në ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar, neni 7, pika 2 gërma “a”, VKM-së nr. 696 datë 30.01.2019 për “Përcaktimin e kufijve territorial e hidrografik të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e Këshillit të secilit prej tyre”, vendimit të KKU-së nr.6 datë 12.06.2019 “Për miratimin e rregullores së KBU-së, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

VENDOSI:

1. Të miratojë konstituimin e Këshillit të Basenit Ujor Ishëm me përbërje sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Emiljan Jani



<i>Nr</i>	<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Institucioni Përfaqësues</i>	<i>Pozicioni në institucionin përfaqësues</i>	<i>Pozicioni në KBU Ishëm</i>
1	Emiljan Jani	Prefekti Qarkut Durrës	Prefekt	Kryetar
<b>Përfaqësues të Bashkive</b>				
2	Ermal Lufo	Bashkia Durrës	Drejtor ekonomik	N/Kryetar
3	Jeta Skënderaga	Bashkia Tiranë	Drejtor	Anëtar
4	Rudolf Ademi	Bashkia Vorë	Përgjegjës Sektori	Anëtar
5	Klodian Laska	Bashkia Krujë	Përgjegjës Sektori	Anëtar
6	Uarda Elezi	Bashkia Kamëz	Nën Kryetar bashkia Kamëz	Anëtar
<b>Përfaqësues të institucioneve rajonale</b>				
7	Marsela Seferi	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Durrës-Dibër-Tiranë	Specialiste	Anëtar
8	Naim Herri	AdZM Rajonale e Zonave të Mbrojtura	Përgjegjës Menaxhimi	Anëtar
9	Haxhire Kasaj	Operatori i Shërbimeve të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor	Drejtor	Anëtar
10	Artan Tanuçi	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	Përgjegjës Sektori, Hidrovor Makineri e rëndë	Anëtar
<b>Përfaqësues të grupeve të interesit</b>				
11	Ermal Spahiu	Grup interesi për mbrojtjen e burimeve ujore	Inxhinier /sektor privat	Anëtar
12	Ardian Mustafaraj	Grup interesi për furnizimin me ujë	Inxhinier /sektori privat	Anëtar
13	Sedi Çausi	Grup Interesi për Furnizimin me ujë	Koordinator UKT	Anëtar
14	Lorenc Bami	Grup Interesi për hidroenergji e industri	Administrator/sektori privat	Anëtar
15	Artur Topçiu	Grup interesi për ujitjen	Inxhinier/sektori privat	Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM DURRËS

Nr 06/prot  
11

Datë, 24 / 05 / 2022

RAPORT

**MBI MBLEDHJEN DHE VENDIMET E DATËS 11.05.2022 TË**

**KËSHILLIT TË BASENIT UJOR ISHËM**

Këshilli i Basenit Ujor Ishëm (KBU) zhvilloi mbledhjen e rradhës në datë **11.05.2022** ora 10<sup>00</sup>:30 .

Në mbledhjen e datës **11.05.2022** morën pjesë 9 anëtarë dhe kryetari i KBU Ishëm, z. Emiljan Jani, duke u plotësuar kourumi për vendimmarrje (10). Gjithashtu morën pjesë :

Z. Helio Huqi drejtor i Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen-Mat (ZABU) në cilësinë e sekretarit të KBU-së, z. Geldon Strugaj pergjegjës i Sektorit të Lejeve dhe Monitorim Kontrollit, znj. Lorena Toci, specialiste e ZABU –së Ishëm-Erzen-Mat me detyrën e mbajtësit të proces-verbalit, znj. Gerta Lubonja Drejtor I Përgjithshme pranë AMBU, z.Arduen Karagjozi, Drejtor pranë AMBU, znj.Ermela Kraja Përgjegjëse Sektori pranë AMBU

Në Këtë takim u bw edhe prezantimi I Planit të Menaxhit të Basenit Ishëm, mundesuar nga BE/ADA (Austrian Development Agency) me përfaqesuesit Znj.Viola Saliaga dhe z. Albert Lenja si dhe përfaqësues të SIDA znj.Enkelejda Gjinali.

Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i KBU-së z. Emiljan Jani duke falënderuar dhe uruar punë të mbarë anëtarëve pjesëmarrës. Anëtarët e KBU - së Ishëm të pranishëm ishin si më poshtë:

1. Artan Tanuçi – Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës
2. Marsela Seferi –Drejtoria Rajonale e Mjedisit
3. Naim Herri – Administrata e Zonave të Mbrojtura
4. Haxhire Kasaj – Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
5. Ermal Lufo – Bashkia Durrës
6. Uarda Elezi – Bashkia Kamëz
7. Rudolf Ademi – Bashkia Vorë
8. Ermal Spahiu – Grupe Interesi
9. Lorenc Bami – Grupe interesi

Pasi anëtarët bënë një prezantim të shkurtër të vetes, meqënëse kjo është mbledhja e parë për z.Emiljan Jani si Kryetar I KBU Ishëm, gjithashtu edhe një pjesë e anëtarëve janë të rinj. Kryetari lejoi zhvillimin e mbledhjes pasi plotësohej kourumi i nevojshëm për organizimin e saj, me *tematikë si më poshtë* :

- Rikonstituimi i Këshillit të Basenit Ujor Ishëm:
- Faza e dytë e konsultimit me publikun e planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm.

**Z. Helio Huqi** merr fjalën duke uruar prefektin për detyrën e tij të re dhe nis me pikën e parë të rendit të ditës “Rikonstituimi i Këshillit të Basenit Ujor Ishëm”, duke theksuar që një pjesë e anëtarëve janë të rinj pasi kanë zëvendësuar anëtarët e mëparshëm, të cilët janë larguar nga detyra e tyre në institucionet që përfaqësonin. Gjithashtu thekson që së shpejti do të ketë një mbledhje tjetër KBU Ishëm për vazhdimin e procedurave për pajisjen me leje të subjekteve që kanë aplikuar pasi në këtë mbledhje KBU-je nuk është futur si rend dite asnjë aplikim duke qenë se si kryetari i KBU-së ashtu edhe një pjesë e anëtarëve janë të rinjë në këtë detyrë

**Z.Emiljan Jani** merr fjalën dhe para se të hedh për votim miratimin e pikës së parë të rendit të ditës, kërkon nga anëtarët që të jenë sa më serioz në këtë detyrë duke bërë një punë sa më rigorozë edhe pse me baza vullnetare, pasi çështjet e ujit janë jetësore.

Thekson gjithashtu që baseni i Ishmit ka mjaft problematika të ndryshme.

Hidhet për votim pika e parë e rendit të ditës dhe të gjithë anëtarët janë dakort, miratohet me të gjitha votat pro Rikonstituimi i Këshillit të Basenit Ujor Ishëm bashkë me listën e re të anëtarëve KBU Ishëm (e cila gjëndet bashkangjitur këtij proces-verbali)

**Z. Helio Huqi** kalon në pikën e dytë të rendit të ditës, duke ju drejtuar znj.Ermela Kraja që të fillojë me prezantimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm.

**Znj.Ermela Kraja** merr fjalën duke bërë një prezantim të shkurtër të vetes dhe nis me prezantimin duke i përmendur dhe shtjelluar pikat e planit një nga një (prezantimi gjëndet bashkangjitur këtij proces-verbali). Pas përfundimit të prezantimit falenderon dhe fton të gjithë pjesëmarrësit në komente dhe diskutime.

**Znj.Gerta Lubonja** merr fjalën duke falenderuar për pjesëmarrjen dhe duke uruar prefektin për detyrën si kryetar KBU-je. Thekson që ky plan menaxhimi do të shërbejë të gjithëve në mbarvajtjen e punës në institucionet që përfaqësojnë secili anëtar, gjithashtu do shërbejë si model edhe për planin e menaxhimit të basenit Erzen, pasi një pjesë e anëtarëve janë anëtarë të KBU Erzen. Znj.Gerta Lubonja fton të gjithë anëtarët që të japin kontributin e tyre në këtë plan menaxhimi duke dhënë komente, pasi për 6 muaj ky plan do jetë i publikuar në faqen zyrtare të internetit para se të kalojë në fazat e tjera të vendimmarrjes. Thekson më tej që ky do jetë plani i parë i mirëfillt i hartuar e miratuar sipas Direktivës Kuadër të Ujit

**Z.Emiljan Jani** vazhdon më tej duke theksuar rëndësinë e dhënjes së kontributit të sejcilit anëtarë me komente e diskutime gjithashtu edhe marrjen parasysh të këtij plani gjatë dhënies së vendimeve në institucionet e tyre për të arritur kështu rezultatin e kërkuar për menaxhimin e Basenit Ishëm. Më pas pyet mbi impiantet e trajtimit të ujrave të ndotur se kur do të fillojnë nga puna.

**Znj.Gerta Lubonja** merr fjalën e thotë që ky plan menaxhimi vjen me një plan masash si dhe ky dokument kalon në Këshillin e Ministrave për të marr një Vendim e për të kaluar më pas ne buxhetim të këtyre masave sidomos në raste të tilla ku kemi të bëjmë me një sasi të konsiderueshme ekonomike. Vazhdon më tej duke thënë që ky plan menaxhimit ka nisur hartimin e tij edhe nga një urdhër i vetë Kryeministrit dhe është një plan që fillon e nuk mbaron asnjëherë pasi gjithmonë ai rishikohet. Për këtë arsye janë të lutur të gjithë anëtarët që ta shohin mirë këtë dokument nëse janë të parashikuara e të përfshira të gjithë kërkesat e institucioneve që përfaqësojnë, sidomos përfaqësuesit e bashkive.

**Z. Helio Huqi** pyet duke ju drejtuar anëtarëve nëse ka ndonje pyetje apo koment për të shtuar, sidomos nga anëtarët e rinjt të cilët nuk njihen akoma mirë me këtë plan menaxhimi.

**Znj. Marsela Seferi** merr fjalën dhe pyet nëse pushtet egzistuese kanë nevojë për pajisjen me leje përdorimi uji, duke qenë se është një anëtare e re e KBU-së dhe nuk ka informacionin për këtë pjesë

**Znj.Gerta Lubonja** sqaron se të gjithë përdoruesit e ujit e kanë detyrim të pajisen me leje përdorimi.

**Z.Arduen Karagjozi** merr fjalën e sqaron më tej se ligji 111/2012 për “Menaxhimin e Integruan të Burimeve Ujore, në lidhje me shfrytëzimin e ujrave nëntokësore ka dy hapa: hapi parë është hapja e pusit që bëhet me leje nga KBU dhe hapi dytë është pajisja me leje përdorimi të këtij pusi po me vendim KBU-je. Thekson që tashmë nuk mund të hapet një pus pa leje pasi bëhesh objekt i penaliteteve dhe sanksioneve të mirëpërcaktura në ligj. Ndërkohë për pushtet egzistuese, duhet të aplikojnë për leje përdorimi të burimit ujor. Duke ju drejtuar vecanërisht Znj. Marsela Seferi, thekson që institucioni juaj duhet ti lëri si detyrë që pas marrjes së Raportit të Vlersimit në Mjedis, të aplikojnë për leje në sistemin tonë elektronik e-Albania.

**Z.Ermal Lufo** merr fjalën duke thënë që me përgjegjësinë që kam në dhënjen e vendimeve, e shoh të rëndësishme që relacionet bashkangjitur projekt-vendimeve duhet të jenë më shpjegues e më me shumë detaje, gjithashtu të paraqesë të gjithë qëndrimin e institucioneve respektive.

**Znj.Gerta Lubonja** thekson edhe njëherë, duke kërkuar reflektimin e anëtarëve, që qëndrimi i përfaqësuesve të institucioneve, duke lënë komentet e tyre në sistemin tonë, është shumë i rëndësishëm por përgjithësisht anëtarët nuk japin komente ndërkohë që kjo duhet bërë brënda

10 ditëve pune nga momenti që dërgohet për mendim tek ju, pas kësaj vazhdojnë procedurat e tjera të vetë sistemit. Kjo është arsyeja pse relacionet janë të vakta dhe thekson që komentet e cdo anëtari janë shumë të rëndësishme në këtë proces vendimarrje.

**Z.Helio Huqi** pyet nëse ka ndonjë koment për të shtuar qoftë për procedurat e vendimarrjes në KBU, qoftë për planin e menaxhimit.

**Znj.Gerta Lubonja** vazhdon më tej duke thënë që ketu në mbledhje kemi përfaqësues të projektit të financuar nga SIDA, të cilët erdhën sot për të parë mënyrën si organizohet mbledhja si dhe për të asistuar në të ardhmen për të gjithë gjërat që ne do kemi nevojë.

**Z.Albert Lenja** merr fjalën duke bërë një prezantim të shkurtër të vetes, dhe duke ju drejtuar të gjithë anëtarëve thekson që plani i menaxhimit është një dokument shumë i rëndësishëm për këtë kam ngulur këmbë që kur punoja në Sekretariatit Teknik e më në fund sot e shohim të implementuar. Është një dokument i vështirë edhe për ne që jemi marrë prej vitesh nda secili nga ju do ketë kohën e nevojshme për tu njohur me të si në rast nevojë do ketë edhe trajnime specifike, pasi me këtë dokument jeni të detyruar të merreni. Ne kemi dy arsye për tu marrë me planin e menaxhimit: e para është që cdo shtet duhet të ketë një plan menaxhimi të burimit ujor të cilat sot kërcënohen seriozisht dhe e dyta sepse kërkojme të aspirohemi në bashkimin europian e ky është një kusht i domosdoshëm Direktiva e Ujit ka treguar që plani i menaxhimit është një mjet i rëndësishëm për të mbrojtur cilësinë dhe sasinë e ujit duke menduar kështu edhe për brezat që vijnë, prandaj ju lutem merrni pak me planin e menaxhimit për tu bërë pjesë e implementimit të tij.

**Z.Emiljan Jani** pyet nëse ka ndonjë koment për të shtuar, meqenëse nuk ka më pyetje apo pika për të diskutuar, Prefekti i Qarkut Durrës deklaroi mbledhjen e mbyllur.

